



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Raporti vjetor për vitin 2015



Prishtinë, Mars 2016

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

HYRJJE

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, bazuar në Ligjin Nr. 03/ L-163 Për Minierat dhe Minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158, është i obliguar që brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, të përgatisë dhe publikojë në faqen zyrtare dhe dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, një raport vjetor, i cili:

- analizon gjendjen e industrisë minerare në Kosovë; dhe
- bën një përmbledhje të të gjitha masave rregullatore, hetuese dhe zbatuese të marra nga KPMM gjatë vitit përkatës kalendarik; megjithatë, ky raport nuk duhet të përmbajë të dhëna lidhur me hetime të cilat janë në vazhdim e sipër, nëse këto të dhëna do të kërcënonin sekretin legjitim të hetimit.

Qëllimi i përgjithshëm i funksionimit të KPMM-së është: promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të Mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimalizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të Mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore në funksion të zhvillimit ekonomik për të mirën e Republikës së Kosovës. Ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e realizuar në bazë të këtyre qëllimeve, brenda një viti kalendarik.

Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetin e bërë në fushën e gjeologjisë - hulumtimit, xehetarisë - shfrytëzimit, përpunimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat e parapara për të ardhmen.

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti në krahasim me strukturën e viteve të kaluara në përgjithësi ka ndryshuar pas rekomandimeve dhe bashkëpunimit që kemi pasur me Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe zyrën ndërlidhës me institucionet dhe agjensionët e pavarura në Kuvendin e RKS-së. Qëllim i të cilit ka qenë harmonizimi i strukturës dhe përmbajtjes së raportit për të gjitha institucionet që i raportojnë për punën e tyre një vjeçare Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për KPMM-në, është viti i dytë që aplikojmë këtë formular të raportimit vjetorë.

Për një rishikim të fokusuar të çështjeve relevante, ne kemi organizuar raportin në këtë mënyrë:

1. Përmbledhja ekzekutive, e cila përshkruan në tërësi raportin dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të punës së Institucionit;
2. Baza Ligjore, në të cilën është e listuar gjithë baza ligjore që rregullon funksionalitetin e institucionit, si dhe vështirësitë ligjore në zbatimin e përgjegjësi të veta;
3. Përshkrimi i Institucionit, e cila përmban përveç tjerash misionin, vizionin, qëllimin dhe kompetencat e KPMM-së, të parapara me Ligjin e Minierave dhe Mineraleve, po ashtu përshkruan organizmat me përgjegjësi kryesore në punën e KPMM-së.
4. Organizimi Institucional, është pjesa në të cilën paraqiten format dhe mënyrat e organizimit të brendshëm, në veçanti përmban të dhëna për Bordin, ekzekutivin dhe personelin e KPMM-së në përgjithësi;
5. Përshkrimi i fushës që e mbulon KPMM-ja, ky kapitull pason me përshkrimin e fushëveprimtarisë të cilën e mbulon, me rëndësi të veçantë, krahasimin e realizimit të planeve, veprimeve të ndërmarra dhe sfidat e tejkaluara dhe të planifikuara për të ardhmen;
6. Puna gjatë vitit paraprak, janë të fokusuara punët specifike të realizuara gjatë vitit 2015, si dhe sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak;
7. Raporti Financiar, është prezantuar buxheti dhe shpenzimet për vitin 2015, i shpalosur me detaje sipas kategorive dhe aktiviteteve të caktuara;
8. Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në këtë pjesë të raportit vjetor janë të prezantuara komentet e ZAP-it dhe adresimi i tyre nga menaxhmenti i KPMM-së, për raportin e auditimit të vitit paraprak; dhe
9. Anekset, është pjesa e fundit e cila përmban të dhëna shtesë të prezantuara në formë të ndryshme të përshtatura sipas natyrës dhe qasjes së informatës ose të dhënës.

Do theksuar, se edhe gjatë vitit 2015, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka bërë angazhim maksimal për luftimin e operatorëve ilegalë, të cilët me vite po i krijojnë probleme të

mëdha këtij institucioni, atyre që operojnë në mënyrë legale, ambientit dhe buxhetit të Kosovës në veqanti. Janë ndërmarrë masat më të rrepta në bashkëveprim me organet përgjegjëse për sekuestrim të mekanizimit me të cilin kanë kryer operim ilegal.

Gjithashtu vlen të theksohet se përkrahje të pakursyer kemi pasur nga Policia e Kosovës. Kurse sa i përket bashkëpunimit me institucionet gjyqësore, në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit të procedimit për rastet e ngritura nga KPMM-ja, rezultatet janë të konsiderueshme. Edhe në këtë vit ka vazhduar procesi i aplikimit të procedurave përmbartimore për arkëtimin e borxheve të papaguara nga kategoria e gjobave administrative. Përderisa bashkëpunim jo të kënaqshëm ose mungesë përkrahje për çështjet e ndërlidhura me aktivitetin minerar kemi pasur me disa nga institucionet përgjegjëse të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Me 06 Maj 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar katër anëtarët e Bordit të KPMM-së, me ç'rast është plotësuar në tërësi ky organ dhe njëkohësisht është bërë funksionalizimi i tij pas një periudhe 13 muajshe të mungesës së kuoromit vendimmarrës.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të vazhdojë me intensitet edhe më të shtuar gjatë vitit 2016, që t'i përkrah dhe mbështes në çdo aspekt të gjithë ata që merren ose pretendojnë të merren me industrinë minerare, njëkohësisht do t'i ndaloj, këshilloj dhe përmirësoj të gjitha ato që bien në kundërshtim me Ligjin dhe rregullat në fuqi për sektorin minerar.

Ne, ju garantojmë se nuk do të kursejmë asgjë për të mirën e përgjithshme të vendit tonë!

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBAJTJA	4
LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE	8
SHKURTESAT:	10
1. PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE	11
1.1. Themelimi	11
1.2. Të arriturat	11
1.3. Objektivat	12
1.4. Sfidat në të ardhmen	12
2. KORNIZA LIGJORE	14
2.1. Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale	14
2.2. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2015	14
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	16
3.1. Vizioni	16
3.2. Misioni	16
3.3. Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale	16
3.4. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së	16
3.5. Përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e aktivitetit mineral në KPMM	17
4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM	18
4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave	18
4.2. Bordi	18
4.3. Ekzekutivi	18
4.4. Burimet Njerëzore	20
4.5. Asetet e KPMM-së	22
4.6. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit	22
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	23
5.1. Shqyrtimi dhe licencimi	23
5.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)	25
5.1.2. Licencat e shfrytëzimit	30
5.1.3. Lejet për Aktivitete të Veçanta	33
5.2. Resurset minerale dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e vendit	36
5.2.1 Minierat e Plumb-Zingut (Pb-Zn)	37
5.2.2 Planifikimi për vitin 2016 – xehes së Plumb-Zingut (Pb-Zn)	38
5.2.3 Minierat hekur - nikelit – Fe-Ni	38
5.2.4 Planifikimi për vitin 2016 – xehes së Hekur-Nikelit (Fe-Ni)	39
5.2.5 Minierat e Kromit– Cr ₂ O ₃	39
5.2.6 Planifikimi për vitin 2016 – xehes së Hekur-Nikelit (Fe-Ni)	40
5.2.7 Linjiti	42
5.2.8 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Linjit	43
5.2.9 Andezite	43
5.2.10 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 - Andezite	44
5.2.11 Argjila	45
5.2.12 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Argjilës	45
5.2.13 Gëlqeror	46
5.2.14 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Gëlqeror	47
5.2.15 Bazalte	47
5.2.16 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Bazalt	48
5.2.17 Dunite	48
5.2.18 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Dunit	49
5.2.19 Rërë dhe Zhavorr	50
5.2.20 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rërës dhe zhavorrit	50
5.2.21 Rërë kuarcore	51
5.2.22 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rërë kuarcore	52
5.2.23 Mergel	52
5.2.24 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Mergelë	53
5.2.25 Rreshpe	54
5.2.26 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rreshpe	54

5.3.	Projektet	55
5.3.1	Përpilimi i një plansheti të hartës gjeologjike në shkallë 1 : 25 000	55
5.3.2	Përpilimi i planit të Menagjimit të Resurseve Minerale të Kosovës, për vitin 2016.....	56
5.4.	Inspektimi dhe monitorimi i aktiviteteve minerare	57
5.5.	Zhvillimi i aktiviteteve inspektuese	57
5.6.	Sasia e eksplozivit e përdorur gjatë 2015	58
5.7.	Raporti i lëndimeve	59
6.	SFIDAT DHE REKOMANDIMET	61
6.1.	Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë	61
6.2.	Rritja e koordinimit ndërinstitucional	61
6.3.	Përafrimi i standardeve teknike me ato evropiane	61
6.4.	Bashkëpunimi ndërinstitucional	61
6.5.	Gjobat Administrative	62
6.6.	Çështja e Ankesave në KPMM	62
6.7.	Çështja e Përmbarimit ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi të KPMM-së.	62
6.8.	Kallëzimet Penale.....	62
7.	RAPORTIMI FINACIAR	63
8.	RAPORTIMI RRETH KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	73
9.	SHTOJCAT	83

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2015.....	14
Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2015	21
Tabela 3: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2015.....	24
Tabela 4: Licencat e lëshuara për hulumtim	25
Tabela 5: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	28
Tabela 6: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	29
Tabela 7: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	30
Tabela 8: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2015.....	30
Tabela 9: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.	32
Tabela 10: Numri i kërkesave të refuzuara për licencim të shfrytëzimit.....	32
Tabela 11: Kërkesat e aprovuara për bartje të kontrollit.	33
Tabela 12: Lista e lejeve për aktivitete të veçanta të lëshuara gjatë vitit 2015	33
Tabela 13: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2015 për leje për aktivitete të veçanta	36
Tabela 14: Numri i kërkesave të refuzuara për mos-plotësimin e kushteve ligjore.	36
Tabela 15: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	37
Tabela 16: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Fe-Ni në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	38
Tabela 17: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr ₂ O ₃ në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	40
Tabela 18: Rezervat e shfrytëzuar në vend burimet metalore për vitet 2012-2015.....	41
Tabela 19: Rezervat gjeologjike dhe të shfrytëzueshme të tanishme në të gjitha vendburimet e licencuara nga KPMM, qoftë të ngelura në vendburimet dikur të licencuara apo dhe në licencat aktive.....	41
Tabela 20: Rezervat e shfrytëzuara sipas lëndëve minerale ndërtimore gjatë vitit 2015	42
Tabela 21: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të linjtit në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	42
Tabela 22: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	43
Tabela 23: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	45
Tabela 24: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	46
Tabela 25: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	47
Tabela 26: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të dunitëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	49
Tabela 27: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015.....	50
Tabela 28: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	51
Tabela 29: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	53
Tabela 30: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	54
Tabela 31: Planifikimi dhe realizimi i qymyri për periudhën Janar – Dhjetor 2015 (m3)	57
Tabela 32: Lëndimet në punë në miniera gjatë vitit 2015	59
Tabela 33: Pasqyra e krahasimeve të lëndimeve për katër vitet e fundit	59
Tabela 34: Pasqyra e krahasimeve të lëndimeve në KEK për pesë vitet e fundit	60
Tabela 35: Buxheti i aprovuar në fillim të vitit 2015	63
Tabela 36: Buxheti pas rishikimit për vitin 2015	63
Tabela 37: Buxheti pas rishikimit për vitin 2015	64
Tabela 38: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2015	65
Tabela 39: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2015.....	65
Tabela 40: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2015	67
Tabela 41: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin për vitin 2015	67
Tabela 42: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për subvencione dhe transfere për vitin 2015.....	68
Tabela 43: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2015.....	68

Tabela 44: Krahاسimi i shpenzime për vitet 2015-2012.....	69
Tabela 45: Vizitat jashtë vendit që janë realizuar në vitin 2015	70
Tabela 46: Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.	70
Tabela 47: Inkasimi i të hyrave për vitin 2015.....	71
Tabela 48: Planifikimi i të hyrave për vitin 2015 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2015	71
Tabela 49: Inkasimi i të hyrave per vitet 2015-2012:	72

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organogrami i KPMM-së	19
Figura 2. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së	20
Figura 3. Lokacioni i KPMM-së	22
Figura 4. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve.....	23
Figura 5. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2011-2015	23
Figura 6. Numri i licencave dhe lejeve të leshuara, gjatë viteve 2011-2015.....	24
Figura 7. Licencat/lejet e leshuara gjatë vitit 2015.....	25
Figura 8. Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	28
Figura 9. Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	30
Figura 10. Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	32
Figura 11. Grafiku i lejeve të leshuara gjatë vitit 2014.	36
Figura 12. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	37
Figura 13. Paraqitje e prodhimitarisë së Pb-Zn dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	38
Figura 14. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Fe-Ni në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	39
Figura 15. Paraqitje e prodhimitarisë së Fe-Ni dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	39
Figura 16. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr ₂ O ₃ në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	40
Figura 17. Paraqitje e prodhimitarisë së Cr ₂ O ₃ dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	40
Figura 18. Rezervat e shfrytëzuar në vend burimet metalore në periudhën 2012-2015.....	41
Figura 19. Rezervat e shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore gjatë vitit 2015	42
Figura 20. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të linjitit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	43
Figura 21. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të linjitit për 2016, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	43
Figura 22. Paraqitje e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	44
Figura 23. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të andezitit për 2016, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	44
Figura 24. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	45
Figura 25. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të argjilës për 2016, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	46
Figura 26. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	46
Figura 27. Paraqitje e prodhimitarisë së gëlqerorëve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	47
Figura 28. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015.	48
Figura 29. Paraqitje e prodhimitarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	48
Figura 30. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	49
Figura 31. Paraqitje e prodhimitarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.....	50
Figura 32. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015.....	50
Figura 33. Paraqitje e prodhimitarisë së rërës-zhavorrit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	51
Figura 34. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	52

Figura 35. Paraqitje e prodhimitarisë së rërës kuarcore dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	52
Figura 36. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	53
Figura 37. Paraqitje e prodhimitarisë së mergelës dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	53
Figura 38. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015	54
Figura 39. Paraqitje e prodhimitarisë së rreshpeve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015	55
Figura 40. Harta gjeologjike e Planshetit Krasmiroc-K34-53 Ab në shkallë 1:25 000.....	56
Figura 41. Planifikimi dhe realizimi i djerrinës	58
Figura 42. Krahasimin i planifikimit dhe realizimit të largimit të djerrinës për pesë vitet e fundit	58
Figura 43. Paraqitja grafike sipas llojit të lëndimeve	59
Figura 44. Paraqitja grafike e krahasimeve të lëndimeve për katër vitet e fundit	59
Figura 45. Paraqitja e zvogëlimit të lëndimeve me diagram për pesë vitet e fundit në KEK-DPQ	60
Figura 46. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2015.....	63
Figura 47. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2015.....	64
Figura 48. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2015.....	64
Figura 49. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2015	65
Figura 50. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2015.....	66
Figura 51. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalit në vitin 2015	68
Figura 52. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Subvencione dhe transfere në vitin 2015	68
Figura 53. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2015	69
Figura 54. Krahasimi i shpenzime për vitet 2015-2012	69
Figura 55. Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.....	71
Figura 56. Inkasimi i të hyrave për vitin 2015	71
Figura 57. Planifikimi i të hyrave për vitin 2015 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2015.....	72
Figura 58. Inkasimi i të hyrave për vitet 2015-2012	72

SHKURTESAT:

APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
Cr ₂ O ₃	Kromiti
Fe-Ni	FerroNikeli
GIS	Sistemi Gjeografik i Informimit (Geographic Information System)
Gjeo	Gjeologjike
INDEP	Instituti për Politika Zhvillimore
ISO 9001:2008	Standardi Ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë
KEK-DPQ	Korporata Energjetike e Kosovës-Divizioni për Prodhimin e Qymyrit
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KSHA	Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave
LMM	Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operator Ekonomik
Pb-Zn	Plumb-Zink
PMRM	Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale
RKS	Republika e Kosovës
SHGJK	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE

1. PËRMBLIDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Themelimi

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e themeluar ne perputhje me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158 (tash e tutje LMM), me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori i cili ka mandat 3 (tre) vjeçar. Struktura dhe stafi tjetër i KPMM-së, përbëhet nga departamentet kryesore me staf profesional dhe njësitë tjera mbështetëse me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KPMM gjatë vitit 2015 ishte 73 të punësuar, nga numri total i aprovuar që ka qenë 79.

1.2. Të arriturat

- KPMM është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare, taksen dhe gjobën administrative. Në vitin 2015 janë inkasuar **30,141,403€ ose 11%** me shume se në vitin paraprak (nga Rentë Minerare 29,699,510.00€, nga Taksa Administrative 292,390.00€ dhe nga Gjyba Administrative 149,503.00€).

- Gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2015 Bordi i KPMM-së ka mbajtur **34** takime, në të cilat janë shqyrtuar **333** kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë kërkesat e ndërmarrjeve që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe kërkesat e ndërmarrjeve të pranuar para vitit **2015**).

- Për shkak të mungesës se kuorumit të Bordit të KPMM-së në vendimmarrje, në një periudhë 13 mujore, është një numër i madhe i takimeve të mbajtura, respektivisht kërkesave të shqyrtuara brenda periudhës Maj-Dhjetor 2015. Qe do të thotë se brenda muajit, mesatarisht, janë mbajtur 4 takime përkatësisht janë shqyrtuar **42** kërkesa për licenca dhe leje.

- KPMM gjatë vitit 2015 ka pranuar gjithsej **202** kërkesa për licenca dhe leje për aktivitete të veçanta.

- Gjatë vitit 2015 KPMM-ja kishte orgnizuar edhe nje workshop per parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, ku kishte perfshire te gjitha institucionet te cilat ne menyre direkte ose indirekte lidhen me ndalimin e aktiviteteve joligjore ku ishin perfshir veq te tjerash edhe Policia e Kosoves, Prokuroria, Gjykatat, ATK-ja etj. Nga ky workshop rezultoi pergaditja e nje Plani te veprimit i cili tani eshte ne tavolinat e qeverise per miratim. Sponzorizues i ketij Plani te Veprimit perveq KPMM-se ishte edhe MMPH-ja dhe MZHE-ja.

- Pas procedimit te të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, brenda vitit 2015, janë lëshuar **163** Licenca dhe Leje.

- KPMM ka refuzuar për mos përmbushje të **kushteve për licencim, 48** kërkesa për licenca dhe leje (Hulumtim **29**, Shfrytëzimi **11**, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë **8**).

- Brenda vitit 2015 lëndë minerare, të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (225,289.00 ton), Fe-Ni (651,918.51 ton), Minerale energjetike (lignit) 8,240,694.00 ton, Minerale industriale (argjila) 104,170.22 ton, Minerale ndërtimore 7,309,998.48 m3.

- Përderisa, gjatë këtij viti janë realizuar **1749** inspektime dhe ato: 1497 të operatorëve legalë :hulumtim 25, të rregullta 54 (me komision 22), shfrytëzim 48, aktivitete të veçanta 40 dhe 1418 inspektime të aktiviteteve për minim (720 fusha para-minuese, 639 Inspektime minimi dhe 59 transfere e furnizim me eksploziv në miniera nëntokësore). Nga inspektimet aktiviteteve minerare të jashtëligjshme janë **identifikuar 73 operues ilegal** (për identifikimin e të cilave janë bërë 91 inspektime), ndaj të cilëve janë ndërmarra masat e nevojshme të parapara për veprimtarinë ilegale në fushën e minierave.

- Në këtë vit janë përcjell 63 kallëzime penale në Prokurorit kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga tereni, për operime ilegale;
- KPMM gjatë vitit 2015 ka përcjell 13 Propozime për Përmbardim, që në vete përmbajnë aktvendimet për gjoha administrative me vlere të përgjithshme 65,293.00€
- Duke pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, buxheti i aprovuar ose final i KPMM-së për vitin 2015 ishte 1,186,273.00€, përderisa i realizuar është 1,129,638.00€, ose rreth 95% e buxhetit të përgjithshëm.
- Meqenëse, për këtë vit KPMM ka pasur buxhetin e limituar për kategorinë e kapitaleve, sipas kërkesës së KPMM-së ndarja buxhetore nga kategoria ekonomike e kapitaleve ishte vetëm për një projekt në vlere 50,000.00€ ndërsa e vlera e ekzekutimit ishte 49,659.00€ (Përpilimi i 1 (një) planshetë të hartave gjeologjike në shkallë 1 : 25 000).

1.3. Objektivat

KPMM, parasheh që të rris efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësi të veta në të ardhmen përmes ngritjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi dhe objektivave të caktuara në veçanti:

- Ndalimi i operimeve ilegale;
- Ngritja e kualitetit të punës dhe sigurisë në punë të ndërmarrjet e licencuara;
- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, përmes aporivimit të Planit për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale;
- Në koordinim dhe në përputhje me misionin dhe objektivin strategjik të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian do bëhet harmonizimi i standardeve teknike me ato evropiane;
- Rritja e investimeve të huaja përmes pjesëmarrjes dhe organizimit të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Në vazhdimësi, ngritjen e nivelit të hyrave nga renta minerare dhe kategorit tjera, njëkohësisht zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme;
- Në përputhje me Ligjin Nr 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, do vazhdojë iniciativë të procedurave ndaj të gjithë debitorëve të KPMM-së;
- Ngritja e nivelit të shërbimeve për palë të treta përmes ofrimit të asistencës teknike dhe profesionale nga KPMM,
- Implementimi i kontrollave të veçanta në vazhdimësi për të menaxhuar rrezikun dhe për t'i mundësuar organizatës tonë funksionimin në mënyrë të planifikuar dhe të koordinuar, dhe
- Zbatimi i politikave të cilësisë, nëpërmjet zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, sipas standardit ISO 9001:2008.

1.4. Sfidat në të ardhmen

Duke marr parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me LMM-në dhe rregullat tjera në përgjithësi, në njërin anë dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre në praktik në anën tjetër, si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, ne mund të veçojmë:

- Operimet ilegale, të cilët po ndikojnë në degradimin e ambientit, dëmtimi i konkurrencës për operatorët e licencuar ose legal, në shqiptimin e një numri të madh gjobash si dhe rritje të borxheve ndaj KPMM-se;
- Mos aprovimi formal i Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Ndalimin e operuesëve ilegal nga ana e Qeverisë dhe apo institucioneve perkatese.
- Mos harmonizimi i kornizës organizative dhe ligjore të sektorit minerar, në veçanti me Ligjin për Pyjet e Kosovës;
- Pamundësia e implementimit të dispozitave ligjore për sekuestrim të mjeteve – makinerisë të rastet e veprimeve ilegale.
- Menaxhim i cili synon sigurimin e resurseve minerale për gjeneratën e tashme dhe ruajtjen e qasjes në resurset natyrore edhe për gjeneratën e ardhshme në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis dhe komunitetet lokale. Mbrojtje maksimale e njohurive, potencialit dhe shfrytëzueshmërisë së resurseve minerale, etj.

- Rritja e numrit të lendeve ose rasteve neper gjykata, shqiptimi i një numri të madh gjobash si dhe rritja e borxheve ndaj KPMM-se;
- Çështja e Përmbartimit ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi të KPMM-së.
- Mungesa e një objektit të përhershëm për zyre. KPMM është e obliguar që të marr me qera objekt privat me një hapësirë prej 1300 m², i cili përveç shpenzimeve të mëdha të qerasë, nuk i përmbush as kushtet si për nga hapësira e po ashtu edhe nga funksionaliteti.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1. Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale

KPMM është themeluar me Rregulloren Nr. 2005/2 që ka hyrë në fuqi me datën 21 janar 2005, e cila është ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-081 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2005/2 të datës 13 qershor 2008, ku përcaktohet si Agjenci e Pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës .

Veprimtarinë e vet, KPMM-ja e zhvillon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i cili nga data 27 gusht 2010 ka hyrë në fuqi dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Minerat dhe Mineralet i cili ka hyrë në fuqi me 02 maj 2013.

KPMM-ja rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra dhe Strategjinë Minerare, e cila vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura aktet e brendshme nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2015.

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2015

Udhëzime Administrative / Rregullore 2010
KPMM 2010_01 Rregullore për procedurat e shqyrtimit të ankesave
KPMM 2010_02 UA Per Uniformat dhe pajisjet mbrojtëse
KPMM 2010_04 UA Caktimi i metodologjise për caktimin e gjobës për operues ilegal
Udhëzime Administrative / Rregullore 2011
KPMM 2011_01 UA Për personat përgjegjes te ndërmarrjet
KPMM 2011_03 UA Për shpenzimet minimale të hulumtimit
Udhëzime Administrative / Rregullore 2012
KPMM 2012_02 UA Për dënimet mandatore
KPMM 2012_03 UA Për blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e mallrave ne KPMM
KPMM 2012_04 UA Rregullat dhe tarifat për palët e treta të kryera nga arkiva e KPMM-se
Udhëzime Administrative / Rregullore 2013
KPMM 2013_01 UA Për shtyrjen e pagesës se rentës minerare
Udhëzime Administrative / Rregullore 2014
KPMM 2014_01 UA Shtyerjet dhe përjashtimet
KPMM 2014_02 UA për të gjitha Sigurimet dhe Garancitë Bankare
KPMM 2014_03 UA për Distanca të shfrytëzimit Minerare nga Rugët
Udhëzime Administrative / Rregullore 2015
KPMM 2015_01 UA Per ndarjen e subvencioneve

2.2. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2015

Punën dhe aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2015 e kanë përcjell një mori vështirësi të cilat në raste të caktuara kanë ndikuar në uljen e efikasitetit të punës së këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

- Mungesa e kuorumit të Bordit për vendimmarrje që nga fundi muajit Prill i vitit 2014 dhe mos emërimi anëtarëve tjerë, deri me 06.05.2015, respektivisht mos kompletimi i Bordit me anëtarët e nevojshëm ka ndikuar në mos realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të parapara me Ligj.
- Mos harmonizimi i ligjeve tjera me LMM-në. Gjatë punës së përditshme në zbatimin e dispozitave ligjore, KPMM ka hasur në vështirësi rreth sigurimeve dhe garancioneve që LMM i ka paraparë për ndërmarrjet e licencuara, kurse më vonë kjo çështje është rregulluar edhe me akte të mbrendeshme - UA.

Sipas nenit 70 të LMM-së, Inspektorati i KPMM-së është kompetent për **sekuestrimin** e mjeteve të punës dhe lëndës minerale të operatorëve ilegalë që hasen në vendshfrytëzim. Lidhur

me këtë çështje kemi hasur në pengesa nga ana e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, ku me rastin e sekuestrimit të mjeteve të punës, duke kërkuar vendim të veçantë nga gjykata kompetente për të pranuar makineritë e sekuestruara. Kjo çështje është sqaruar me shkrim nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, se nuk ka nevojë për vendim të veçantë nga gjykatat, sepse dispozitat e LMM-së e cekin shprehimisht se është kompetencë e KPMM-së sekuestrimi i mjeteve në rastet e veprimit ilegal.

Problem në vete paraqet edhe çështja e zhvillimit të procedurës ligjore nëpër gjykata duke i lënë lëndët të vjetërsohen si dhe shqiptimi i masave joadekuate në raport me veprën penale të kryer duke iu shqiptuar denime me kushte për veprimet ilegale, gjë që nuk e ka efektin e duhur ligjor në shumë raste.

Mos harmonizimi i Ligjit për Pyjet e Kosoves me LMM-në, ngase kemi raste kur sipërfaqja që duhet të shfrytëzohet, në kopjen e planit dhe listën poseduese shkruan se kultura është mal, ndërsa APK-ja nuk është pronare e ngastrës dhe megjithëatë kërkohet pëlqim nga APK-ja.

Poashtu, APK-ja lëshohen pëlqime në sipërfaqe maksimale deri në 5 hektarë dhe në kohëzgjatje prej 5 viteve, kurse sipas LMM-së është e paraparë që kohëzgjatja e licencave për shfrytëzim të mineraleve ndërtimore mund të jetë deri 25 vite me mundësi vazhdimi edhe për 25 vite tjera. Kurse, për mineralet energjetike deri në 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite tjera.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. Vizioni

Hulumtimi dhe shfrytëzimi i resurseve minerare, zgjerimi e modernizimi i industrisë së përpunimit mineral për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

3.2. Misioni

Krijimi i të gjithë hapësirës institucionale përmes shërbimeve cilesore, për rritjen e shpejte të investimeve në sektorin mineral, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore

3.3. Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin për minierat dhe mineralet, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare.

3. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale.

4. Paraqet vepër penale dhe shkelje të ligjit nëse një person ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në KPMM-në, personelin ose menaxhmentin e saj.

3.4. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së

1. KPMM ka autoritetin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë për të siguruar:

1.1. Ligjshmerinë në hulumtimin dhe shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare në Kosove;

1.2. Pajtuëshmëria e operimeve minerare me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin dhe kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMM, apo pëlqimeve të lëshuara si parakusht për miratim nga KPMM, në pajtim me ligj.

2. KPMM ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve në vijim, në përputhje me Ligjit për Miniera dhe Minerale:

2.1. lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e Licencave dhe Lejeve;

2.2. themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare; dhe

2.3. nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së;

3. KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.

4. Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me Ligjin për Minierat dhe Mineralet;

5. KPMM-ja mund të lëshojë këto Licenca dhe Leje pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e këtyre Licencave dhe Lejeve në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale:

- 5.1. Licenca për hulumtim;
- 5.2. Licenca për mbajtjen e të drejtave;
- 5.3. Licenca për shfrytëzim;
- 5.4. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta;
- 5.5. Licenca për shfrytëzim zejtar;
- 5.6. Licenca ose Leja në Interes të Publikut.

3.5. Përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e aktivitetit minerar në KPMM

Të gjitha kompetencat e KPMM-së ushtrohen nga Bordi i KPMM-së. Çdo vendim i cili sipas ligjit të minierave kërkohet të merret nga KPMM-ja duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM-së. Përderisa Drejtori i KPMM-së drejton veprimtarinë e zakonshme të KPMM-së dhe ushtron të gjitha funksionet e deleguara nga Bordi i KPMM-së.

Megjithatë, KPMM-ja funksionalizimin dhe realizimin efikas dhe efektiv të kompetencave dhe përgjegjësi të veta e realizon përmes organizmave profesional të ngritur në nivele departamentesh. Struktura e KPMM-së përbëhet nga departamentet kryesore dhe departamentet ose njësitë tjera mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së.

Në kuadër të departamenteve me përgjegjësi kryesore bëjnë pjesë:

1. Departamenti Inspektoratit të Minierave;
2. Departamenti i Gjeologjisë;
3. Departamenti i Gjeodezisë;
4. Departamenti i GIS-it;
5. Departamenti i Financave;
6. Departamenti Ligjor.

Përderisa si mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së, por edhe me përgjegjësi të përcaktuara, bëjnë pjesë këto departamente:

1. Departamenti i Administratës;
2. Departamenti i Prokurimit;
3. Departamenti i TI-së; dhe
4. Njësia e Auditimit të Brendshëm

4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM

4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave

Në përputhje me LMM-në, si dhe Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, KPMM e ka të rregulluar strukturën e vet organizative.

4.2. Bordi

KPMM drejtohet nga Bordi ("Bordi i KPMM") i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas këtij ligji kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM. Mandatet e të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestar janë pesë (5) vjet. Anëtarët e Bordit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil. Gjate ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisve të tyre sipas këtij ligji, anëtarët e bordit do të veprojnë ekskluzivisht në interes të publikut dhe me mirëbesim. Anëtarët e bordit të KPMM-se emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga data 06.05.2015 është i kompletuar Bordi me emërimin e 4 anëtarëve të Bordit. Ndërsa anëtarit të pestë që ka qenë me mandat, i ka përfunduar mandati më 07.12.2015.

Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit organizon edhe takime shtese.

Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat për licenca dhe leje, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që i plotësojnë kriteret për t'u përcjellë në Bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

4.3. Ekzekutivi

Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori dhe Kryeinspektori. Drejtori është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së, i cili bënë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjet e Bordit dhe merret me ekzekutimin e vendimeve të marrura nga Bordi. Drejtori dhe Kryeinspektori i KPMM-së bazuar në legjislacionin në fuqi kanë mandat 3 vjeçar.

Menaxhmenti i mesëm në KPMM janë drejtorë të departamenteve dhe janë nëpunës civilë. Sipas ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civilë janë punëtorë të karrierës me afat të pacaktuar.

Në figurën më poshtë është paraqitur organogrami i KPMM-së.

4.4. Burimet Njerëzore

Me Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, KPMM-së i janë aprovuar 79 pozita. KPMM-ja nuk ka arritur ti plotësoj te gjitha pozitat e planifikuara dhe miratuara per shkak te shkurtimeve bugjetore nga MF ne qershor 2015 ne menyre te njëanshme. Deri në fund të vitit 2015 KPMM ka arritur t'i plotësojë 73 pozita.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Ligjit Nr. 04/L-158 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03L-163, Ligjit Nr. 04/L-232 për Sherbimin Gjeologjik të Kosovës dhe në përputhje me pikën 6 të Rekomandimeve të Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nr. O5/526/Ra-04; të Kuvendit të Republikës së Kosovës të datës: 19.05.2015; KPMM dhe SHGJK më datën 13.08.2015 kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për Transferimin e Personelit, Dokumentacionit Gjeologjik dhe Labororit nga KPMM në SHGJK.

Sipas kësaj marrëveshje, 3 punëtorët e Labororit Gjeologjik janë transferuar nga KPMM në SHGJK, por kanë mbetur në listën e pagave të KPMM-së deri më 31.12.2015.

KPMM ka personel me kuadër të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafikun në vijim.




Figura 2. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së

Niveli i pagave të stafit në KPMM është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Bordit janë staf profesional të emëruar, dhe pagat e tyre janë të përcaktuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilat që nga viti 2007 nuk kanë ndryshuar. Drejtori dhe stafi tjetër ekzekutivë janë nëpunës civilë dhe pagat i kanë të përcaktuara sipas legjislacionit për shërbyes civilë (me koeficientë). Për shkak të natyrës specifike të punës së KPMM-së, përveç pagës bazë, stafi i KPMM-së ka të aprovuara nga MF dhe Kuvendi i Kosovës edhe shtesa në pagë, sipas specifikave të punës për pozita.

Gjatë vitit 2015 një numër i punëtorëve të KPMM-së ka marrë pjesë në trajnime si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Një numër i trajnimeve janë organizuar nga IKAP, por edhe një pjesë e trajnimeve janë organizuar nga institucione tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detajet e trajnimeve të stafit të KPMM-së të realizuara gjatë vitit 2015:

Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2015

Emri e Mbiemri i pjesmarrësit	Ofruesi i Trajnimit	Lloji i trajnimit	Vendi	Kohezgjatja
Gani Nekaj	FLSA	Trajnim në Prokurim Publik	Shqipëri	4 ditë
Vesel Hajzeri	FLSA	Trajnim në Prokurim Publik	Shqipëri	4 ditë
Haradin Gërvalla	IKAF	Trajnim në Kontabilitet	Prishtinë	vazhdimësi
Ekrem Gorçi	BM Consulting	Trajnim në Administratë	Maqedoni	4 ditë
Lahije Hyseni	Cactus	Trajnim në Teknologji Informative	Prishtinë	vazhdimësi
Selvete Grajçevci	IKM	Trajnim në Financa	Turqi	4 ditë
Vjollca Gjonbalaj	IKM	Trajnim në Financa	Turqi	4 ditë
Vesel Hajzeri	BIP	Trajnim në Prokurim Publik	Shqipëri	3 ditë
Fatmire Mulaj	IKM	Trajnim në Burime Njerëzore	Turqi	4 ditë
Haradin Gërvalla	IKM	Trajnim në Financa	Shqipëri	4 ditë
Halit Gara	IKM	Trajnim në Financa	Shqipëri	4 ditë

4.5. Asetet e KPMM-së

Për kryerjen e aktiviteteve të veta, KPMM ka në posedim një numër të madh të aseteve funksionale si:

- Informacionet gjeoshkencore
- Gjeodatabazën e Kosovës
- Harduerë dhe Softuerë të avansuar
- Pajisje të Logjistikës (vetura) etj.

4.6. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit

Objekti i zyreve të KPMM-së ndodhet në Breg të Diellit në rrugën Armend Daci, nr.1 në Prishtinë. Më poshtë është paraqitur harta e lokacionit të objektit të zyreve të KPMM-së.



Figura 3. Lokacioni i KPMM-së

Në mungesë të objektit të përhershëm për zyre, KPMM është e obliguar që merr me qera objekt privat me një hapësirë prej **1300 m²**, i cili përveç shpenzimeve të mëdha të qerasë, nuk i përmbush as kushtet si për nga hapësira e poashtu edhe nga funksionaliteti.

Edhe pse disa herë KPMM iu ka drejtuar institucioneve përkatëse me kërkesë që të vendoset në objektet e institucioneve publike, ende nuk është bërë një zgjidhje, prandaj KPMM vazhdon të qëndrojë me qera në objekte private, që nga viti 2004.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 2010-2015, për hapësirë për zyre me qera KPMM ka shpenzuar nga Buxheti i Kosovës shumën prej **416,084.93 €**.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. Shqyrtimi dhe licencimi

Bordi i KPMM-së në takimet e mbajtura gjatë vitit 2015, përveç kërkesave të pranuar gjatë vitit **2015** ka shqyrtuar edhe kërkesat e pranuar në vitet paraprake.

KPMM-ë gjatë vitit **2015** ka pranuar gjithsej **202** kërkesa për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit, si dhe kërkesa për leje për aktivitete të veçanta, prej tyre:

- Kërkesa për Licenca të hulumtimit – **100**.
- Kërkesa për Licenca të shfrytëzimit – **43**.
- Kërkesa për leje për aktivitete të veçanta **59** (separacione **38**, bazë betoni **19**, bazë asfalti **2**).
- Si dhe ka trajtuar 157 ankesa dhe kërkesa te kompanive apo personave fizik

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur numri i aplikacioneve të pranuar sipas muajve, gjatë vitit **2015**.




Figura 4. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2011-2015.




Figura 5. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2011-2015

Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, janë lëshuar **162** Licenca dhe Leje për aktivitete të veçanta. Prej tyre janë: **75** licenca për hulumtim dhe **26** licenca për shfrytëzim, si dhe **61** Leje për aktivitete të veçanta (bazë asfalti **8**, bazë betoni **15**, separacione **38**) – shih tabelën në vijim. Pra, Bordi i KPMM-se gjatë vitit **2015** gjithsejtë ka shqyrtuar **333** kërkesa-aplikacione të Hulumtimit kanë qenë **147**, **83** për shfrytëzim si dhe **103** për aktivitete të veçanta.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i licencave dhe lejeve të leshuara, gjatë viteve **2011-2015**.




Figura 6. Numri i licencave dhe lejeve të leshuara, gjatë viteve 2011-2015

Tabela 3: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2015

Nr. Rendor	Lloji i licences	Numri i licencave të aprovuara
1	Licenca për hulumtim	75
2	Licenca për shfrytëzim	26
3	Leje për aktivitete të veçanta	61
	Total	162

Ndryshimi në mes të aplikacioneve dhe licencave të aprovuara është se të gjitha kërkesat për licenca dhe Leje për Aktivitete të Veçanta nuk i kanë plotësuar kushtet Ligjore për t'u licencuar.




Figura 7. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2015

5.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)

“Licencë për Hulumtim” nënkupton autorizimin zyrtar me shkrim të lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës III të LMM-së.

Licenca për hulumtim të mineralet ndërtimore lëshohet në afat jo më shumë se 2 vite. Vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 50 ha. Mund të vazhdohet edhe për një periudhë kohore maksimale prej 2 viteve.

Për planifikim të prodhimit për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015 grafiku i mëposhtëm.




Figura 27. Paraqitje e prodhimit të gëlqerorëve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

Në grafikun e më sipërm është paraqitur mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake, nga ku vërehet se nevoja e shfrytëzimit të gëlqerorëve ka ndryshime mirëpo me një tendencë rritje graduale. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të gëlqerorëve për vitin 2016 mund të jetë 5,200,000.00 m³.

3.1.14 Bazalte

Shfrytëzimi i bazaltit për vendburime të veçanta bëhet me minim dhe pa minim e bazuar kjo në specifikat të vendburimeve, duke pas parasysh këtë në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrjet dhe minimet në vitet gjegjëse, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 25: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Minim) në %
		m ³		
2012	118,900.00	8,743.14	0.00	0.00
2013	118,900.00	9,704.70	9,704.70	8.16
2014	118,900.00	10,942.51	10,964.18	9.22
2015	118,900.00	8,271.34	8,271.34	6.96




Figura 28. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015.

Nga tabela dhe grafiku i më sipërm mund të vërehet një ndryshim i madh në mes të planifikimit dhe realizimit. Për dallim, në vitin 2015 ka një përafrim të planifikimit me realizim.

3.1.15 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Bazalt

Për planifikim të prodhimit për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015, grafiku i mëposhtëm.




Figura 29. Paraqitje e prodhimit të bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake nga ku rrjedhë së sasia e shfrytëzimit të bazaltit nuk dëshmon rritje, por në të kundërtën gjatë vitit 2015 ka pësuar rënie të dukshme. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të bazaltit për vitin 2016 mund të jetë 9,000.00 m³.

3.1.16 Dunite

Shfrytëzimi i dunitëve për vendburime të veçanta bëhet më minim sipas specifikave të vendburimeve. Duke pas parasysh këtë, në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur rezervat e shfrytëzuara sipas raportimeve nga ndërmarrjet dhe minimet, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 26: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të dunitëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Minim)
	m ³			në %
2012	255,400.00	95,303.78	95,283.90	37.31
2013	254,400.00	1,783,317.39	1,783,317.21	700.99
2014	185,760.88	206,116.98	0.00	0.00
2015	405,400.00	160,219.11	160,219.11	39.52




Figura 30. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

3.1.17 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Dunit

Për planifikim të prodhimtarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015, grafiku i mëposhtëm.

Paraqitje e prodhimtarisë së dunit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015, është bërë në grafikun e mëposhtëm.




Figura 31. Paraqitje e prodhimitarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

3.1.18 Rërë dhe Zhavorr

Shfrytëzimi i Rërës dhe zhavorrit për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 27: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2012	76,831.00	23,198.57	30.19
2013	72,906.00	25,398.55	34.84
2014	74,235.50	26,142.10	35.22
2015	52,750.00	7,957.80	15.09




Figura 32. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka ndryshim të dukshëm në mes të planifikimit dhe realizimit. Sipas grafikut të më sipërm mundë të vërehet se në dy vitet e parafundit sasia e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit ka vlera përafërsisht të barabarta, ndërsa ka një rënie në vitin e fundit.

3.1.19 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rërës dhe zhavorrit

Për planifikim të prodhimitarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, grafiku i mëposhtëm.




Figura 33. Paraqitje e prodhimit të rërës-zhavorrit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. Nga 2012 deri më 2014 vërehet se nevojat për rërë dhe zhavorr kanë pësuar rritje, ndërsa pas vitit 2015 shfrytëzimi ka pësuar rënie graduale. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit për vitin 2016 mund të jetë 15,000.00 m³.

3.1.20 Rërë kuarcore

Shfrytëzimi i Rërës kuarcore për vendburime te veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 28: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2012	93,375.00	22,490.00	24.09
2013	230,500.00	27,371.00	11.87
2014	141,500.00	120,667.70	85.28
2015	147,000.00	16,467.00	11.20

Nga tabela e më sipërme dhe në grafikun e më poshtëm mund të vërehet se ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit. Tek ndërmarrjet që shfrytëzojnë rërë kuarcore po ashtu është vështirë më bërë planifikim real, ngase ka shfrytëzues të pa ligjshëm.




Figura 34. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

3.1.21 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rërë kuarcore

Për planifikim të prodhimtarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, grafiku i mëposhtëm.




Figura 35. Paraqitje e prodhimtarisë së rërës kuarcore dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. Në përgjithësi vërehet se deri në vitin 2013 ka një shfrytëzim pothuajse konstant, ndërsa gjatë vitit 2014 është shënuar rritje e dukshme e sasisë së shfrytëzuar, dhe ka rënie të serishme gjatë vitit 2015. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rërës kuarcore për vitin 2016 mund të jetë 25,000.00 m³.


3.1.22 Mergel

Shfrytëzimi i Mergëles për vendburime të veçanta janë paraqitë në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 29: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2012	561,961.00	128,161.00	22.81
2013	1,360,307.00	411,073.00	30.22
2014	1,140,000.00	310,953.00	27.28
2015	1,303,800.00	284,962.00	21.86


Nga tabela e më sipërme dhe në grafikun e më poshtëm mund të vërehet se ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit.

**Figura 36. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015**

Nga grafiku i më sipërm vërehet se planifikimi dhe shfrytëzimi i mërgelës ka pas mospërputhje të madhe në vazhdimësi, ndërsa prodhimtaria ka qenë më ndryshime ritmike.

3.1.23 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Mergelë

Për planifikim të prodhimtarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012-2015, grafiku i mëposhtëm.

**Figura 37. Paraqitje e prodhimtarisë së mergelës dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015**

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. KPMM-ja për momentin e ka të licencuar një ndërmarrje më dy licenca për shfrytëzim të mergelës. Mundë të vërehet se gjatë vitit 2014 ka pas rënie të sasisë së rezervave të shfrytëzuara, për të vazhduar kështu dhe gjatë vitit 2015. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të mergelës për vitin 2016 mund të jetë 280,000.00 m³.

3.1.24 Rreshpe

Shfrytëzimi i reshpeve për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015.

Tabela 30: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2012	0.00	0.00	
2013	10,000.00	4,600.00	46.00
2014	10,000.00	5,146.00	51.46
2015	10,000.00	900.00	9.00




Figura 38. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2012-2015

Nga grafiku i më sipërm vërehet se shfrytëzimi i rreshpeve ka qenë më ndërprerje dhe në vazhdimësi ka pas mospërputhje të madhe.

3.1.25 Nevojat dhe planifikimi për vitin 2016 – Rreshpe

Për planifikim të prodhimtarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2012–2015, grafiku i mëposhtëm.




Figura 39. Paraqitje e prodhimit të rreshpeve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarinë nga 2012-2015

Në përgjithësi vërehet se nga 2013 deri në 2014 ka një tendencë rritje të nevojave për shfrytëzim të rreshpeve, ndërsa në vitin 2015 ka pas një rënie të menjëhershme. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rreshpeve për vitin 2016 mund të jetë 1,800.00 m³.

5.3. Projektet

5.3.1 Përpilimi i një plansheti të hartës gjeologjike në shkallë 1 : 25 000

Detyrë e projektit ka qenë përpilimi i hartës gjeologjike në shkallën 1 : 25 000 të planshetit K34-53 Ab. Ky projekt kërkim – vlerësimi parësor në themel të tij ka hartografimin e rajonit të marrë në studim, me të gjithë komponentët e nevojshëm. Rezultatet e këtij studimi do të ngrenë në një nivel më të lartë njohuritë gjeologjike për këtë rajon, kapacitetet prodhuese, zhvillimin e integruar të popullsisë dhe rritjen e nivelit ekonomik të sajë. Hartografimet gjeologjike në shkallë 1 : 25 000 do të jenë një bazë e shëndoshë për menaxhimin më të mirë të territoreve. Ato do të jenë baza për hartat gjeomjedisore, hidrogeologjike, gjeologo – inxhinierike, agrogeologjike etj., grafiku i mëposhtëm.




Figura 40. Harta gjeologjike e Planshetit Krasmiroc-K34-53 Ab në shkallë 1:25 000

Harta gjeologjike e planshetit është e shoqëruar dhe me tekst përshkrues.

5.3.2 Përpilimi i planit të Menagjimit të Resurseve Minerale të Kosovës, për vitin 2016

Sipas Ligjit për Miniera Minerale Nr.03/-163 Neni 74 respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit bazik neni 45, KPMM është e obliguar që: Gjatë tremujorit të fundit të secilit vit kalendarik të përgatit dhe dorëzon në ministri Projekt Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Kosovës.

Për zhvillim më efektivitet, të sigurt dhe të vazhdueshëm të vendburimeve minerale të Kosovës KPMM-ja merr parasysh disa aspekte më rendësi si: Ofrim i këshillave gjeo-shkencore dhe informata të domosdoshme gjeologjike organeve qeveritare nëse nga ato kërkohet, si dhe palëve të treta sipas interesimit të tyre, koordinim me institucionet e tjera për të siguruar që prioritetet janë të analizuar dhe që planifikimi për të ardhmen është kryer për një zhvillim më të mirë të vendburimeve minerale të vendit, të sigurohet që institucionet e tjera të mos nxjerrin jashtë përdorimit resurset minerale natyrore, duke ngritur mbi to apo afër tyre çfarëdo infrastrukture etj.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) dhe Plani i Menaxhimit të Resurseve minerale të Kosovës (PMRMK) kanë rendësi për caktimin e zonave potenciale për planifikime të veçanta për zhvillim të veprimtarisë minerare.

5.4. Inspektimi dhe monitorimi i aktiviteteve minerare

Inspektorati i Minierave ka kompetencën e përgjithshme për të inspektuar aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta të cilitdo person, për të konstatuar:

- 1.1. nëse personi i cili ushtron ato aktivitete posedon Licencë ose Leje të dhënë nga KPMM;
- 1.2. nëse personi posedon Licencë ose Leje, për të konstatuar nëse aktivitetet janë duke u ushtruar në përputhje me Licencën ose Lejen përkatëse dhe rregulloret zbatuese të sigurisë dhe mjedisore të nxjerra nga Ministri në përputhje me LMM-në.

5.5. Zhvillimi i aktiviteteve inspektuese

Aktiviteti minerar për shfrytëzimin e linjtit është mjaft kompleks, ngase për të ardhur deri të lënda e parë minerale, paraprakisht duhet larguar djerrina (mbulesa).

Largimi i djerrinës nënkupton fazën paraprijëse të shfrytëzimit të linjtit ku në raport janë të evidentuara sasitë e largimit dhe etapat e largimit të djerrinës nga viti 2011 e deri në vitin 2015 në minierën e KEK-ut.

Gjatë vitit 2015 KEK-u është planifikuar largimin e masave të djerrinës në sasinë prej 12,500,000 m³ ndërsa realizimi është bërë në sasinë prej 10,037,332m³ apo në përqindje 80,3% .

Ndikim të drejtpërdrejtë në ulje të realizimit të largimit të djerrinës, e që sjell pasoja në të ardhmen në shfrytëzimin e Qymyreve, ka pasur PROBLEMI I SHPRONËSIMIT TË PRONAVE PRIVATE.

Tabela 31: Planifikimi dhe realizimi i gymyri për periudhën Janar – Dhjetor 2015 (m3)

	Planifikimi	Realizimi
JANAR	920,000	662,167
SHKURT	1,015,000	785,160
MARS	985,000	790,866
PRILL	735,000	869,058
MAJ	1,130,000	833,809
QERSHOR	1,010,000	1,083,565
KORRIK	1,020,000	1,174,596
GUSHT	1,350,000	975,946
SHTATOR	1,090,000	654,278
TETOR	1,085,000	559,391
NENTOR	1,180,000	951,593
DHJETOR	980,000	696,903
Total	12,500,000	10,037,332

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e planifikimit dhe realizimit të djerrinës për periudhën Janar – Dhjetor 2015 edhe në formë diagrami:




Figura 41. Planifikimi dhe realizimi i djerrinës

Me anë të diagramit po paraqesim krahasimin e planifikimit dhe realizimit të largimit të djerrinës për pesë vitet e fundit:




Figura 42. Krahasimin i planifikimit dhe realizimit të largimit të djerrinës për pesë vitet e fundit

Si përfundim i kësaj rrjedh se aktiviteti minerar në Sektorin e Sitnicës, ka përfunduar sa i përket largimit të djerrinës dhe nxjerrjes së Qymyrit, dhe se hapësira e mbetur në atë zonë do të shfrytëzohet për transportin hidraulik të Hirit nga Divizioni i Gjenerimit.

5.6. Sasia e eksplozivit e përdorur gjatë 2015

Në vitin 2015 sasia e eksplozivit e hargjuar në total për miniera nëntoksore është Q=200,730.4 kg, dhe sasia e eksplozivit e hargjuar për miniera sipërfaqësore është Q=3,444,512.06 kg.

Dhe se si përfundim i sasia e masese vëllimore e miniuar në miniera sipërfaqësore është V=6,642,897.06m³, dhe konsumi specifik për m³ është q=0.51 kg/m³.

5.7. Raporti i lëndimeve

Në vazhdim po paraqesim raportin e shkurtuar të lëndimeve duke pasë parasysh sasinë aq të madhe të eksplozivit të përdorur si në Minierat nëntokësore po ashtu edhe në ato sipërfaqësore.

Aksidentet - lëndimet në punë në miniera gjatë vitit 2015 sipas llojit të lëndimeve në minierat nëntokësore:

Tabela 32: Lëndimet në punë në miniera gjatë vitit 2015

	TOTAL 2014	TOTAL 2015
Fatalitet	0	0
Lëndim kolektiv	0	0
Lëndim I rëndë	5	4
Lëndim I lehtë	18	72




Figura 43. Paraqitja grafike sipas llojit të lëndimeve

Vlen të përmendet se si faktorë i ndikimit të minimizimit të lëndimeve në minierat nëntokësore ka pasur Trajnimi dhe Certifikimi i kandidatëve për Minandezës, i cili Certifikim është bërë nga Inspektorati i KPMM-së.

Dhe si pasqyrë e krahasimeve të lëndimeve po e paraqesim me diagram për katër vitet e fundit:

Tabela 33: Pasqyra e krahasimeve të lëndimeve për katër vitet e fundit

	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Fatalitet	2	0	0	0
Lëndim kolektiv	2	1	0	0
Lëndim I rëndë	15	8	4	4
Lëndim I lehtë	45	70	18	72




Figura 44. Paraqitja grafike e krahasimeve të lëndimeve për katër vitet e fundit

Dhe po ashtu edhe në minierat Sipërfaqësore (KEK-u), po paraqesim numrin e lëndimeve nëpër muaj për pesë vitet e fundit:

Tabela 34: Pasqyra e krahasimeve të lëndimeve në KEK për pesë vitet e fundit

Lendimet		Muajt kalendarik												Total
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
V I T E T	2011	12	5	4	5	5	1	1	4	8	8	4	7	64
	2012	4	7	7	2	2	2	2	3	9	2	1	1	42
	2013	2	5	2	3	4	3	3	2	2	6	6	6	44
	2014	3	0	1	4	1	2	0	3	1	3	0	1	19
	2015	1	0	1	1	0	1	0	3	3	2	3	2	17

Paraqitja e zvogëlimit të lëndimeve me diagram për pesë vitet e fundit në KEK-DPQ:




Figura 45. Paraqitja e zvogëlimit të lëndimeve me diagram për pesë vitet e fundit në KEK-DPQ

Dhe se më qëllim të arritjes së objektivave të KEK-ut për zvogëlimin e numrit të punëtorëve të aksidentuar është më se e nevojshme të vazhdohet me trajnimet e stafit udhëheqës por edhe të vetë punëtorëve duke e bërë edhe verifikimin e tyre lidhur me trajnimet e bëra.

Dhe se është kënaqësi të përfundohet se në Guroret industriale nuk e kemi as edhe një lëndim të raportuar.

6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET

6.1. Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë

Një ndër synimet kryesore të Inspektoratit të Minierave, në vazhdimësi edhe për tërë vitin 2015 është parandalimi i operatorëve ilegal në sektorin e minierave si dhe vazhdimi i sekuestrimit të mjeteve dhe lëndëve minerale të operatorëve ilegal.

Disa nga faktorët ndikues në ndalimin e operimeve ilegale që kanë shkaktuar ngecje gjatë marrjes së masave ndëshkuese nga Inspektorati i Minierave kanë qenë:

- Mos miratimi i planit të veprimit për parandalimin dhe ndalimin e operuesve ilegal nga ana e Qeverisë dhe apo institucioneve relevante.
- Joazhureteti i organeve të drejtësisë në shqyrtimin e kallëzimeve penale të proceduara në gjykata nga ana e KPMM-se (në kohët e fundit ka progres të konsiderueshëm) ;
- Mosdënimi i operuesve ilegal nga gjykata siç parashihet në nenin 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale;
- Mos arrestimi i operuesve ilegal nga ana e policisë siç është paraparë në nenin 70 të Ligjit për Miniera dhe Minerale;
- Edhe pse është nënshkruar marrëveshja me Agjencinë për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar, i njëjti ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për vendosjen dhe ruajtjen e mjeteve dhe lëndëve minerale të sekuestruara në depot e caktuara në rajone.

Inspektorati i Minierave në tërësi i përmbahet dhe e zbaton Ligjin për Miniera dhe Minerale duke përfshirë edhe nenin 70 pika 3 për sekuestrimin e mjeteve dhe lëndëve minerale të operatorëve ilegalë.

Edhe pse gjatë këtij viti ka rezultate të mira, Inspektorati i Minierave në bashkëpunim me institucionet tjera do të vazhdojë që të pamundësojë aktivitetet e operimeve ilegale në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës.

Numri i përgjithshëm i inspektimeve në kuadër të Inspektoratit për vitin 2015 është 1749, duke përfshirë këtu të gjitha veprimtaritë me të cilat ka të bëjë Inspektorati në kuadër të KPMM-se.

6.2. Rritja e koordinimit ndërinstitutional

- Në këtë vitë është rritë bashkëpunimi ndërinstitutional në zbatimin e ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare. Bashkëpunimi është rritë në vazhdimësi me komunitetin si dhe janë mbajtur takime me të gjitha institucionet relevante që ndërlidhen me veprimtarinë e Inspektoratit të Minierave.
- Poashtu janë bashkërenditur veprimet e përbashkëta në ndalimin e operatorëve ilegalë me asistencë të Policisë së Kosovës, ndihmesën e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Kuvendet Komunale.

6.3. Përafrimi i standardeve teknike me ato evropiane

Edhe pse funksionimi i sektorit mineral në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prap se prap Inspektorati i Minierave është angazhuar që në bashkëpunim me institucionet relevante të përveçësoshë standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së si:

- Promovimi i kulturës për siguri dhe mbrojtje në punë
- Zbatimi rigoroz i masave të mbrojtjes dhe sigurisë në parandalimin e aksidenteve dhe avarive në minierat me shfrytëzim sipërfaqësor dhe nëntokësorë.
- Sigurimi i sistemit efikas të monitorimit të inspektimeve dhe hetimeve në rastet e aksidenteve dhe avarive në punë dhe evidentimi i rregullt i tyre deri te procedimi i këtyre lëndëve në gjykata.

6.4. Bashkëpunimi ndërinstitutional

KPMM në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional ka realizuar takime të shumta me institucione tjera: Ministria e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Kryeprokurorin e

shtetit, Komunitet e Kosovës, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjensionin Pyjor të Kosovës. Bashkëpunimi me këto institucione ka rezultuar me firmosjen e shumë memorandumeve të mirëkuptimit, të cilat kanë pasur për qëllim koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të zgjidhjes së problemeve të ndërsjella.

6.5. Gjobat Administrative

Departamenti Ligjor i KPMM-së gjatë vitit 2015 ka përgatitur 122 Aktvendime për Gjoka administrative lidhur me operimet ilegale, duke e respektuar qarkoren për operimet ilegale dhe konsiderojmë se në tërësi është përmbushur qarkorja. Vlen të theksohet se ka pasur një bashkëpunim dhe koordinim shumë të mirë ndërmjet departamenteve të KPMM-se.

6.6. Çështja e Ankesave në KPMM

Komisioni shqyrtues i Ankesave në KPMM ka mbajtur 18 seanca për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave nga palët e ndryshme që i janë drejtuar KPMM-së.

Nga të gjitha këto seanca janë përgatitur 18 procesverbale të cilat të përgatitura prezantohen në Bord të KPMM për shqyrtim që sipas evidencës që kemi numri i tyre i përgjithshëm është 157 ankesa dhe kërkesa.

Prej 157 ankesave dhe kërkesave të ndryshme KSHA ka shqyrtuar 132, ndërsa 25 të tjera do të shqyrtohen në takimin e radhës nga KSHA.

Departamenti ligjor ka përgatitur gjithsej 172 aktvendime mbi shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave në vitin 2015, në të cilat 82 janë vendime nga ankesat dhe kërkesat që kanë mbetur pa u shqyrtuar nga viti paraprak.

6.7. Çështja e Përmbarrimit ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi të KPMM-së.

Procedura Përmbarrimore është fazë e fundit për përfundimin e një procesi Gjyqësor apo administrativ. Është procedurë mjaft komplekse dhe e rëndë por duhet gjithsesi të vazhdojmë me procedimin e lëndëve për përmbarrim, tani sipas legjislaturës së re tek përmbarruesit privat. Nga KPMM-ja në vitin 2015 janë përcjellë 13 Propozime për Përmbarrim që në vetë përmbajtje shumë aktvendime për Gjoka administrative.

Procedura Përmbarrimore do të vazhdojë edhe më tutje deri në përfundimin e të gjitha rasteve të cilat janë bërë Titull Ekzekutiv

Ka probleme të mëdha në përcaktimin e lëndëve si titull ekzekutiv, kjo është problem dhe sfidë në vetë.

Kjo sfidë mbetet prioritet për vitin 2016, që në mënyrë paralele të gjitha rastet të cilat nuk kanë shkuar e që janë bërë titull ekzekutiv dhe të gjitha lëndet e reja të cilat bëhen të plotfuqishme duhet të përcillen tek përmbarruesit privat për përmbarrim.

6.8. Kallëzimet Penale

Me parashtrimin e denoncimit penal nga KPMM-ja, Prokuroria Publike sipas detyrës zyrtare (ex officio) fillon hetimet për operuesit ilegal dhe gjatë gjithë procedurës KPMM duhet të bashkëpunojë me prokurorinë të ofrojë prova, fakte, sqarime, dëshmi etj.

Në vitin 2015 janë përcjellë 63 kallëzime penale në Prokurorit kompetente në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni për operime ilegale dhe janë në procedurë të shqyrtimit nga gjykatat kompetente.

7. RAPORTIMI FINACIAR

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 ka qenë i ndarë në këto 5 (pesë) linja buxhetore si më poshtë.

Tabela 35: Buxheti i aprovuar ne fillim te vitit 2015

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2015
1	Paga dhe Mëditje	772,518.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	402,699.00 €
3	Komunali	30,600.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	20,000.00 €
5	Projekte Kapitale	50,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,275,817.00 €




Figura 46. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2015

Pas rishikimit të buxhetit për vitin 2015, buxheti i rishikuar është si në tabelën e mëposhtme

Tabela 36: Buxheti pas rishikimit per vitin 2015

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2015
1	Paga dhe Mëditje	700,050.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	386,281.00 €
3	Komunali	30,600.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	20,000.00 €
5	Projekte Kapitale	50,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,186,931.00 €

Ky ndryshim ka ndodhur me rishikim të buxhetit.




Figura 47. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2015

Duke e pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar dhe atë të rishikuar, në tabelën e më poshtme është prezantuar buxheti final për vitin 2015.

Tabela 37: Buxheti pas rishikimit për vitin 2015

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2015
1	Paga dhe Mëditje	712,787.45 €
2	Mallra dhe Shërbime	385,430.67 €
3	Komunal	25,054.72 €
4	Subvencione dhe Transfere	13,000.00 €
5	Projekte Kapitale	50,000.00 €
	Totali i Aprovuar	1,186,272.84 €





Figura 48. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2015

Me vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fund të vitit 2015 ka ndodhur disa lëvizje buxhetore dhe atë si më poshtë:

1. Shtim ne kategorinë ekonomike paga dhe mëditje ne vlerë prej 12,737.46 €. Sipas vendimit te Qeveris Nr. 12/64 i dt. 16.12.2015.
2. Zvogëlim ne kategorinë ekonomike mallra & shërbime ne vlerë prej 850.33 €. Sipas vendimit te Qeveris Nr. 09/65 i dt. 23.12.2015.
3. Zvogëlim ne kategorinë ekonomike komunal ne vlerë prej 5,545.28 €. Sipas vendimit te Qeveris Nr. 09/65 i dt. 23.12.2015.
4. Zvogëlim ne subvencione dhe transfere ne vlerë prej 7,000.00 €. Sipas vendimit te Qeveris Nr. 05/67 i dt. 30.12.2015.

Tabela 38: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2015

Nr. Ren.	Përshkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Ndryshimi	Ne %
1	Paga dhe Mëditje	712,787.45 €	712,787.45 €	- €	100.00
2	Mallra dhe Shërbime	385,430.67 €	331,864.46 €	53,566.21 €	86.10
3	Komunali	25,054.72 €	22,327.19 €	2,727.53 €	89.11
4	Subvencione	13,000.00 €	13,000.00 €	- €	100.00
5	Projekte Kapitale	50,000.00 €	49,658.79 €	341.21 €	99.32
	Totali i Aprovuar	1,186,272.84 €			
	Totali i Shpenzuar		1,129,637.89 €		
	Totali i Mbetje			56,634.95 €	
	Totali në %				95.23

**Figura 49. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2015**

Ne tabelën e më poshtme janë prezantuar Shpenzimet për paga dhe mëditje, Pagat neto, tatimi, dhe kontributet pensionale të punëtorit dhe punëdhënësit.

Tabela 39: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudh të vitit 2015.

Nr. Ren.	Pershkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Diferenca	Ne %
1	Pagat Neto	599,502.63	599,502.63	-	100.0
2	Tatimi ne Paga	45,398.74	45,398.74	-	100.0
3	Kontributi i Puntorit	33,943.04	33,943.04	-	100.0
4	Kontributi i Pudhensit	33,943.04	33,943.04	-	100.0
	Total	712,787.45	712,787.45	-	100.0




Figura 50. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2015

Sa i përket mëditjeve, stafi i KPMM-ës nuk ka mëditje përveç atyre që kanë udhëtuar zyrtarisht jashtë vendit, shpenzimet e udhëtimit zyrtar janë realizuar sipas Vendimit Nr. 2213/1, të Ministrisë së Financave, të cilat do të prezantohen në tabelën financiare nr. 45.

Në tabelën e më poshtme është prezantuar tabela për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në këtë tabelë është bërë shpalosja në bazë të kodeve ekonomike, të planifikuara, të shpenzuara, diferenca dhe shpenzimi për kategori ekonomike, në %.

Tabela 40: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2015

Nr. Rën.	Përshkrimi i Lendeve	Ko di eko no mik	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Perqindja e shpenzuar
Totali shpenzimeve te udhetimit dhe avanseve			64,000.00 €	60,739.37 €	3,260.63 €	
1	Shpenzimet e udhetimit jasht vendit	13140	13,000.00	12,421.16	578.84	95.5
2	Meditjet jasht vendit	13141	2,500.00	330.40	2,169.60	13.2
3	Akomodimi	13142	15,000.00	14,446.39	553.61	96.3
4	Shpenzimet tjera jasht vendit	13143	33,500.00	33,541.42	- 41.42	100.1
Telekomunikacionit			26,350.00 €	22,275.35 €	4,074.65 €	
5	Shpenzimet e Internetit per KPM M-ne	13310	1,400.00 €	1,324.16	75.84 €	94.6
6	Shpenzimet tjera telefonike - Vala	13320	22,500.00 €	19,215.88	3,284.12 €	85.4
7	Sherbimet postare	13330	2,050.00 €	1,337.40	712.60 €	65.2
8	Shpenzimet per Kabllorik	13340	400.00 €	397.91	2.09 €	99.5
Totali i shpenzimeve dhe shërbimeve te ndryshme			31,350.00	7,002.33	24,347.67	
9	Sherbimet e Arsimit dhe trajnimit	13410	6,850.00 €	1,117.00	5,733.00 €	16.3
10	Sherbimet te ndryshme shëndetësore	13430	3,500.00 €		3,500.00 €	0.0
11	Sherbimet e ndryshme intelektuale-kshillëdhense	13440	7,000.00 €	3,100.00	3,900.00 €	44.3
12	Sherbimet e shtypjes - Jo Marketingut (bllokat)	13450	600.00 €	28.00	572.00 €	4.7
13	Sherbimet Kontraktuese tjera	13460	10,000.00 €	712.61	9,287.39 €	7.1
14	Sherbimet Teknike	13470	1,900.00 €	1,834.72	65.28 €	96.6
15	Shpenzimet per Antarësim	13480	1,500.00 €	210.00	1,290.00 €	14.0
Totali i mobiljeve dhe paisjeve me pak se 1000 €			43,000.00 €	41,227.23 €	1,772.77 €	
16	Mobilje me pak se 1000 - Inventar	13501	4,000.00 €	3,594.00	406.00 €	89.9
17	Telefona (me pak se 100euro)	13502	1,000.00 €		1,000.00 €	0.0
18	Komputera (me pak se 1000 euro)	13503	15,000.00 €	14,861.34	138.66 €	99.1
19	Furnizim me paisje tjera me pak se 1000 euro	13509	23,000.00 €	22,771.89	228.11 €	99.0
Totali i furnizimeve tjera			25,000.00 €	22,647.84 €	2,352.16 €	
20	Furnizimi i Zyres (Material shpenzues)	13610	16,500.00 €	14,408.40	2,091.60 €	87.3
21	Furnizimi me Ushqim dhe pije -jo dreka zyrtare	13620	- €		- €	#DIV/0!
22	Furnizim Pastrimi	13640	- €		- €	#DIV/0!
23	Rrobat per Stafin e Terenit	13650	8,500.00 €	8,239.44	260.56 €	96.9
Totali i derivatet dhe lëndëve djegëse			54,000.00 €	50,654.07 €	3,345.93 €	
24	Vaj per Nxemje	13720	8,600.00 €	7,044.22	1,555.78 €	81.9
25	Derivate per Generator	13770	600.00 €		600.00 €	0.0
26	Karburante per vetura	13780	44,800.00 €	43,609.85	1,190.15 €	97.3
Totali i shërbimeve te regjistrimit dhe sigurimit te autove			28,723.20	27,318.51	1,404.69	
27	Regjistrimi automjeteve	13950	2,600.00 €	2,535.00	65.00 €	97.5
28	Sigurimi i Automjeteve	13951	12,500.00 €	12,216.09	283.91 €	97.7
29	Taksa komunale per regjistrim te automjeteve	13952	260.00 €	260.00	- €	100.0
30	Sigurimi i nderteses te KPM M-se	13953	13,363.20 €	12,307.42	1,055.78 €	92.1
Totali i mirëmbajtjeve			40,189.23	28,682.95	11,506.28	
31	Mirëmbajtja e veturave te KPM M-se	14010	25,139.23 €	20,006.29	5,132.94 €	79.6
32	Mirëmbajtja e nderteses - pastrimi	14020	8,550.00 €	6,559.67	1,990.33 €	76.7
33	Mirëmbajtja e teknologjis informative	14040	5,000.00 €	1,593.19	3,406.81 €	31.9
34	Mirëmbajtja e paisjeve dhe mobileve	14050	1,500.00 €	523.80	976.20 €	34.9
Totali i shpenzimeve te qiras			62,082.14	62,082.14	-	
35	Shpenzimet e qiras dhe te tatimit	14110	62,082.14 €	62,082.14	- €	100.0
36	Rezervimi i salles per prezantim	14150	- €		- €	#DIV/0!
Totali i shpenzimeve te marketingut			5,600.00	5,262.70	337.30	
37	Botimet dhe publikimet	14210	4,600.00 €	4,560.00	40.00 €	99.1
38	Shpenzimet per informim publik te KPM M-se	14230	1,000.00 €	702.70	297.30 €	70.3
Totali i shpenzimeve te perfaqesimit			2,500.00	1,345.20	1,154.80	
39	Dreka Zyrtare	14310	2,500.00 €	1,345.20	1,154.80 €	53.8
Totali i shpenzimeve te vendimeve gjyqsore			2,636.10	2,626.77	9.33	
40	Shpenzimet per gjykata	14410	2,300.00 €	2,290.67	9.33 €	99.6
41	Pages nga Thesari		336.10 €	336.10	- €	100.0
Totali			385,430.67 €	331,864.46 €	53,566.21 €	86.10

Ne tabelën e më poshtme është paraqitur buxheti i aprovuar, shpenzuar, diferenca dhe është prezantuar në %, për kategorinë ekonomike Komunal.

Tabela 41: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunal për vitin 2015

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Rryma	16,500.00 €	16,385.78 €	114.22 €	99.31
2	Telefoni dhe faksi	7,054.72 €	4,836.13 €	2,218.59 €	68.55
3	Shpenzimet e Ujit	1,500.00 €	1,105.28 €	394.72 €	73.69
	Totali	25,054.72 €	22,327.19 €	2,727.53 €	89.11




Figura 51. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin në vitin 2015

Në tabelën e më poshtme është paraqitur buxheti i aprovuar, shpenzuar, diferenca dhe është prezantuar në %, për kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfer.

Tabela 42: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për subvencione dhe transfere për vitin 2015

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Subvencione e Transfere	13,000.00 €	13,000.00 €	- €	100.00
	Totali	13,000.00 €	13,000.00 €	- €	100.00




Figura 52. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Subvencione dhe transfere në vitin 2015

Në vazhdim është prezantuar tabela e projekteve kapitale

Tabela 43: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2015

Nr. R.	Pershkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Ndërtimi i një plansheti të hartës gjeologjike	50,000.00	49,658.79	341.21 €	99.3
	Totali për shpenzime Kapitale	50,000.00 €	49,658.79 €	341.21 €	99.3




Figura 53. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2015

Ne tabelën e më poshtme është paraqitur tabela krahasuese për katër vitet e fundit për të gjitha kategoritë ekonomike, si më poshtë:

Tabela 44: Krahasimi i shpenzime për vitet 2015-2012

Nr. Ren.	Përshkrimi	Shpenzuar në vitin 2015	Shpenzuar në vitin 2014	Shpenzuar në vitin 2013	Shpenzuar në vitin 2012
1	Paga dhe Mëditje	712,787.45 €	619,387.65 €	597,866.20 €	606,181.23 €
2	Mallra dhe Shërbime	331,864.46 €	355,588.73 €	341,130.59 €	390,593.63 €
3	Komunali	22,327.19 €	22,862.19 €	21,706.04 €	34,816.46 €
4	Subvencione dhe Transfere	13,000.00 €	- €	- €	- €
5	Projekte Kapitale	49,658.79 €	555,159.56 €	412,397.55 €	230,793.16 €
	Totali i Shpenzimeve	1,129,637.89 €	1,552,998.13 €	1,373,100.38 €	1,262,384.48 €




Figura 54. Krahasimi i shpenzime për vitet 2015-2012

Ne tabelën e mëposhtme janë prezantuar vizitat jashtë vendit që janë realizuar ne vitin 2015.

Tabela 45: Vizitat jashtë vendit që janë realizuar në vitin 2015

Nr.	Vendi i Udhëtimit	Lloji i udhëtimit	Numri i pjesëmarrësve	Kohëzgjatja	Shpenzimet e udhëtimit
1.	Shqipëri	Trajnim: “Kontratat Publike Kornizë, Shërbimet Konsulente, Menaxhimi i Kontratave në Prokurimin Publik dhe Ankesat”	2	06.02.2015 09.02.2015	1,626.64 €
2.	Maqedoni	Trajnim: “Menaxhimi Administrativ, Procesi i Komunikimit, Hartimi i Shkresave, Raporteve, Procesverbaleve dhe Arkivimi i Dokumenteve”	1	20.02.2015 23.02.2015	666.20 €
3.	Shqipëri	Vizitë pune në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore	5	25.02.2015 01.03.2015	3,352.85 €
4.	Kanada	Konferenca PDAC	2	28.02.2015 06.03.2015	2,183.65 €
5.	Turqi	Trajnim: “Menaxhimi, Certifikimi dhe Ekzekutimi i Pagesave në Organizatat Buxhetore, sipas Rregullave të reja financiare”	2	20.04.2015 23.04.2015	1,789.60 €
6.	Shqipëri	Takim pune në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (renta minerare)	3	16.06.2015 18.06.2015	1,176.00 €
7.	Bullgari	Konferenca SGEM	3	16.06.2015 25.06.2015	4,953.00 €
8.	Maqedoni	Vizitë pune në Ministrinë e Ekonomisë të Maqedonisë, për rentën minerare	3	25.06.2015	175.56 €
9.	Shqipëri	Takim pune në Ambasadën e Rumanisë në Shqipëri, për Kongresin e 6-të Ballkanik të Minierave 2015	2	14.09.2015	154.66 €
10.	Rumani	“The sixth Balkan Mining Congress 2015, Romania”	1	19.09.2015 24.09.2015	2,146.13 €
11.	Gjermani	Konferenca INTERGEO 2015	3	13.09.2015 18.09.2015	4,639.78 €
12.	Shqipëri	Kongresi i 2-të Ndërkombëtar i Rrugëve	5	23.09.2015 26.09.2015	3,367.76 €
13.	Turqi	Pjesmarrje në seminarin: “Future of Explosives, Safety & Security, Design Parameters and Environmental Effects of Blasting Operations”	5	02.10.2015 06.10.2015	5,529.75 €
14.	Shqipëri	Trajnim Profesional nga fusha e prokurimit	1	22.10.2015 24.10.2015	626.99 €
15.	Shqipëri	GIS Conferenca Esri Education	6	20.10.2015 23.10.2015	3,438.33 €
16.	Turqi	Trajnim: “Shfrytëzimi i sistemit informative për menaxhimin e Resurseve Njerëzore në institucione publike në Kosovë”	1	30.10.2015 02.11.2015	962.20 €
17.	Shqipëri	Trajnim: “Menaxhimi i Shpenzimeve dhe Mbyllja e Vitit Fiskal në Organizatat Buxhetore në Kosovë”	2	10.12.2015 13.12.2015	1,556.64 €
18.	Londër-UK	Konferenca: Mines & Money London 2015	4	29.11.2015 05.12.2015	22,393.63 €

Ne tabelën e mëposhtme janë prezantuar pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.

Tabela 46: Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.

Nr. Ren.	Përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike	
1	Sh. e Pjesmarrjes ne konferenca, kongrese, seminare dhe trajnime	19,575.80 €
2	Shpenzimet e akomodimit	14,446.39 €
3	Shpenzimet e ushqimit	17,902.44 €
4	Shpenzimet e meditjeve	330.40 €
5	Shpenzimet e biletave	6,165.70 €
6	Shpenzimet tjera	2,318.64 €
Totali i shpenzimeve		60,739.37 €




Figura 55. Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera

Tabela 47: Inkasimi i të hyrave për vitin 2015

Nr. Ren	Pershkrimi	Kodi ekonomik	Inkasimi i te Hyrave 2015
1	Taksa Administrative	50019	292,390
2	Gjoba Administrative	50107	149,503
3	Renta Minerare	50203	29,699,510
	Totali		30,141,403




Figura 56. Inkasimi i të hyrave për vitin 2015

Tabela 48: Planifikimi i të hyrave për vitin 2015 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2015

Nr	Pershkrimi	Te hyrat e Planifikuara 2015	Te Hyrat e inkasuara 2015	Ndryshimi
1	Taksat Administrative	238,000.00	292,389.55	- 54,389.55
2	Gjobat Administrative	150,000.00	149,503.02	496.98
3	Renta Minerare	27,750,000.00	29,699,510.21	- 1,949,510.21
	Totali	28,138,000.00	30,141,402.78	- 2,003,402.78




Figura 57. Planifikimi i të hyrave për vitin 2015 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2015

Tabela 49: Inkasimi i të hyrave per vitet 2015-2012:

Nr	Pershkrimi	Inkasimi për vitin 2015	Inkasimi për vitin 2014	Inkasimi për vitin 2013	Inkasimi për vitin 2012
1	Taksat Administrative	292389.55	280705.45	392,742	345,885
2	Gjobat Administrative	149503.02	147246.15	168,853	180,496
3	Renta Minerare	29699510.21	26538979.42	24,693,417	5,887,154
	Totali	30,141,403	26,966,931	25,255,012	6,413,535




Figura 58. Inkasimi i të hyrave per vitet 2015-2012

Detyrimet e ndërmarrjeve në vite ndaj KPMM-së janë 16,569,623.77 €

KPMM-ja gjate vitit 2015 ka dërguar ne gjykata përkatëse 13 aktvendime për procedura përmbartimore, vlera e këtyre aktvendimeve e shprehur e euro është 65,292.50 €.

KPMM-ja gjate vitit 2015, ka bere 63 kallzime penale ne gjykata përkatëse për ndërmarrjet të cilat aktivitetin e vet minerare e kanë zhvilluar ilegal.

Trepça Artanë, Stantërg, Belobërdo dhe Cërnac nuk i ka kryer obligimet financiare ndaj KPMM-së, detyrimet e këtyre Minierave ndaj KPMM-së për vitin 2015 janë 703,261.00 €, ndërsa si total obligimi i Trepçës është 5,689,692.68 €.

8. RAPORTIMI RRETH KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

8.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e rregullsisë në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e veta. ZAP ka dhënë opinionet dhe vlerësimet e veta për fushëveprimtarin dhe fokusimet e auditimit

8.1.1 Opinioni Auditori të Përgjithshëm mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale që kanë përfunduar me 31.12.2014: Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200/1705 Opinion i Pamodifikuar).

8.1.2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm: KPM ka arritur të dorëzojë me kohë të gjitha raportet të cilat kërkojnë me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullës Financiare nr. 06/2011;

8.1.3 Rekomandimet e vitit paraprak: Që nga pranimi i rekomandimeve tona për vitin 2013, KPM ka ndërmarrë masa për t’i adresuar shqetësimet e ngritura. Përkundër progresit në adresimin e rekomandimeve, edhe më tutje disa çështje mbeten për t’u adresuar.

8.1.4 Qeverisja: Kontrollët mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit marrë si tërësi ishin relativisht të mira. Megjithatë, te kategoria e investimeve kapitale kërkohej një zhvillim i mëtejshëm i procesit buxhetor. Me theks të veçantë, nevojitet t’i kushtohet vëmendje analizave lidhur me kostot për projekte kapitale për të evituar suficitin në fund të vitit.

Më tutje, kontrollët mbi menaxhimin e licencave, sigurimin e garancioneve bankare, parandalimin e aktiviteteve ilegale dhe masave për inkasimin e llogarive të arkëtueshme kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Ato në raste të caktuara ishin shmangur nga legjislacioni në fuqi. Në këtë aspekt, kontrollët duhet të forcohen për të siguruar që objektivat e KPM-së arrihen ashtu si janë planifikuar.

Kontrollët në menaxhimin e shpenzimeve ishin të mira. Megjithatë, kontrolle shtesë nevojiten te menaxhimi i procesit të prokurimit dhe procedimit të pagesave. Më tutje, kontrollët menaxheriale në proceset e rekrutimit të stafit të ri dhe avancimit të stafit të KPM-së duhet të përmirësohen më tutje. Ndërsa, nga aspekti i rëndësisë së mesëm kontrolle shtesë nevojiten edhe në raportimin e obligimeve të papaguara dhe menaxhimin programit e- pasurisë

8.1.5 Sistemi i Auditimit të Brendshëm: Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) në kuadër të KPM-së përbëhet nga Drejtori. NJAB ka përgatitur planin vjetor për vitin 2015, si dhe planin strategjik për periudhën 2015 – 2017.

Vlerësimi ynë është se NJAB ka kryer punën konform Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Planit vjetor. Raportet ishin cilësore dhe të dokumentuara me dëshmi adekuate. Këto raporte i kishin ofruar Menaxhmentit pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtejshëm.

Tabela, në vijim paraqet komentet (të gjeturat), Rekomandimet dhe nivelin e zbatueshmeris se tyre për çdo komponent ose çështjeje te audituar.

Nr	Komponentët ose Çështjet e Audituar		Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
	Te gjeturat	Rekomandimet			
1.	1. Çështja – Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioriteti – i rëndësishëm			Plani i Veprimit të Menaxhmentit (PVM-ja) është përgatit dhe aprovuar brenda afatit të paraparë. Janë përshkruar qartë të gjitha veprimet e nevojshme për realizim përkatësisht zbatim të rekomandimeve. Po ashtu të gjitha rekomandimet janë adresuar tek personat kompetent dhe me përgjegjësi. Bordi i KPMM-së, përmes Auditorit të Brendshëm ka hartuar tri raporte për tre muaj rresht mbi gjendjen e përgjithshme të rekomandimeve.	
	<u>E gjetura 1:</u> Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht sepse KPMM nuk ka zbatuar ndonjë plan formal për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e rekomandimeve të AP-it.	<u>Rekomandimi 1:</u> Kryesuesi i Bordit duhet të zbatojë një proces të qartë për monitorimin e adresimit të rekomandimeve të AP-së. Rekomandimet të cilat nuk adresohen sipas afateve, të rishikohen në baza mujore nga Kryesuesi, si dhe veprime pro aktive të ndërmerren ndaj sfidave të paraqitura gjatë zbatimit.			
	2. Çështja 2 – Planifikim jo i mirë i buxhetit për projekte kapitale- Prioritet i lartë				

2.	<u>E gjetura 2:</u> Sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) dhe tabelës 3.2 të buxhetit për projekte kapitale, për vitet 2013/14 projekti “<i>Menaxhimi i resurseve minerale</i>” ishte buxhetuar në shumën prej 200,000€ (100,000€ vitin 2013 dhe 100,000€ në 2014). Përderisa, vlera e kontraktuar e projektit ishte 126,090€ apo 37% më vogël se vlera e buxhetuar. Po ashtu, edhe projekti “<i>Ortofotot</i>” ishte buxhetuar në vlerë prej 50,000€ ndërsa vlera e kontraktuar ishte 27,400€ apo 55% më e vogël se vlera e buxhetuar.	<u>Rekomandimi 2:</u> 2 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen.	Po		
3.	<u>Çështja 3 – Mos raportimi i rregullt në periudha tremujore dhe vjetore nga bartësit e licencave-Prioritet i lart</u> <u>E gjetura 3:</u> Sipas Ligjit Nr. 03/L-163 nenit 34, dhe ligjit Nr 04/L-158 për plotësim dhe ndryshim të ligjit bazë, bartësit e licencave për shfrytëzim do të dorëzojnë raporte tremujore dhe vjetore me shkrim në KPMM. Përmes këtyre raporteve informohet KPMM sa i përket vëllimit apo sasisë së mineraleve të prodhuara, si dhe shumën e rentës minerare të cilën duhet të ja paguaj bartësi i licencës KPMM-së. Disa nga bartësit e licencave për shfrytëzim nuk kishin raportuar në departamentet përkatëse në	<u>Rekomandimi 3:</u> Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr masa adekuate për ta rritur shkallën e përgjegjësis brenda departamenteve përkatëse në mënyre që të rezultoj me ngritje të efikasitetit për raportim në pajtueshmëri me kërkesat ligjore nga	Po		

	KPMM në lidhje me sasinë apo vëllimin e mineraleve të prodhuara, si dhe vlerën në para të rentës minerare të cilën e kanë për obligim që t'ja paguajnë KPMM-së për secilin tremujorësh.	bartësit e licencave.			
4.	Çështja 4 - Mos revokim i licencave apo lejeve në mungesë të garancioneve bankare dhe polisave të sigurimit ndaj palëve të treta-Prioritet i lart		Po		
